

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil**, gjyqtari Misin Frangu, me zyrtaren ligjore Arbelinda Tahiri, në çështjen juridike të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BSK) me seli në Prishtinë, kundër të paditurit [REDACTED] nga Ferizaj, Rr. [REDACTED]” nr [REDACTED], për shkak të rimbursimit të dëmit, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 23.11.2017, mori këtë:

### AKTGJYKIM

*- për shkak të padëgjueshmërisë / mosbindjes -*

- I. **APROVOHET** në tërësi kërkesëpadija e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BSK) me seli në Prishtinë, si e bazuar.
- II. **DETYROHET** i padituri [REDACTED] nga Ferizaj, që paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BSK) t’ia rimburosojë mjetet në emër të kompensimit të dëmit, në shumë prej **745.00 €** (shtatëqind-e-katërdhjetë-e-pesë-euro) me kamatë ligjore nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

### A r s y e t i m i

Paditësja, në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurit, për rimbursimin e mjeteve në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar nga aksidenti automobilistik. Si provë, paditësja ka sjellur raportin policor mbi aksidentin në komunikacion nr.2012-GR-0922 i datës 28.06.2012; vendimin mbi kompensimin e dëmit BKS: FK-1108/2012 i datës 18.08.2012; ujdinë jashtëgjyqësore nr.1108/12 i datës 05.10.2012 dhe urdhërpagesën e datës 16.10.2012.

Gjykata, të paditurit, me datë 19.02.2016 ia ka dërguar padinë së bashku me provat e lëndës si dhe aktvendimin për përgjigje në padinë e paditëses, por i padituri, ndonëse i ka pranuar shkresat me rregull (provë: fletëkthesa e nënshkruar nga i padituri me datë 14.03.2016) brenda

afatit të caktuar ligjor, me aktvendimin për dhënien e përgjigjes në padi, nuk ka ushtruar në këtë gjykatë përgjigjen e tij nëse e kundërshton apo jo kërkesëpadinë e paditëses, ndërsa gjykata nga provat e çështjes, ka gjetur se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet e tilla nuk janë në kundërshtim me provat e propozuara nga paditësja, si dhe duke pasur parasysh faktin se i padituri e ka pranuar me rregull padinë me prova dhe aktvendimin për përgjigje në padi (personalisht), gjykata bazuar në nenin 150.6 të LPK-së, ka vendosur që të marrë aktgjykim kontumacional, pa dëgjimin e palëve ndërgjygjëse.

Gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë nga neni 150.2 të LPK-së, që përjashton mundësinë për nxjerrjen e aktgjykimit të tillë, në rastin konkret.

Gjykata lidhur me kamatën ka vendosur në bazë të nenit 378 të LMD-së, duke qenë se për paditësen, lartësia e borxhit ka qenë e përcaktuar që në kohën e ngritjes së padisë.

### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.868/15, me datë 23.11.2017

Gjyqtari,

Misin Frangu



**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të tij, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ / FERIZEVAC

Më  
Dana

27.11.2017

